



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr. 274/2014**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala Kryesues, Nenad Lazić dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën parashtruar nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega Drenas, paraqitur kundër Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Drenas, për shkak të thyerjes të heshtjes zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 11.06.2014, mori këtë:

**VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e parashtruar nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Drenas i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1000 (njëmijë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**Arsyetim**

Me datën 09.06.2014, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Drenas, në të cilën pretendohet se gjatë ditës të Zgjedhjeve me datën 08.06.2014 rreth orës 12:00 në Qendrën e Votimit në shkollën “Rasim Kiçina” në Drenas veturat me logon “Misioni i ri” kanë qëndruar për një kohë të gjatë në hyrje të Qendrës së Votimit. Andaj me këtë veprim është bërë shkelje e dispozitave të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme përkatësisht Neni 36, të Rregullës Zgjedhore nr. 11/2013 të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët, Neni 7, Rregullën Zgjedhore Nr.09/2013, Neni 12 pretendohet në ankesën e LVV-së.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë dy fotografi dhe emrin e një aktivisti të LVV-së i cili e ka raportuar shkeljen.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4, paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-i me datë 10.06.2014 e informoi subjektin politik PDK, për ankesën që është bërë kundër këtij subjekti politik nga LVV dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 11.06.2014, në ora 12:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i nuk mori përgjigjen në ankesë nga subjekti politik PDK.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e bazuar**

Në fotografit e ofruara si prova që gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se si veturat me logon “Misionit i ri” nga subjekti politik PDK, kanë qëndruar në Qendrën e Votimit në shkollën “Rasim Kiqina” në Drenas në ditën e zgjedhjeve me 08 Qershor.

PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura konstatoi se subjekti politik PDK ka rënë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LZP-së dhe është përgjegjëse për veprimet e saja duke shkelur Nenin 7 paragrafi 1 pika a) dhe b) të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013 dhe Nenin 36 paragrafi 1 pika a) dhe b) të LZP-së, i cili përcakton se *”Njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjektet politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet secili prej veprimeve a) shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, ose 100 metra brenda hapësirës së të njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi tek votuesit, b) bërja e fushatës në çfarëdo mënyre “* veprime këto që e bëjnë përgjegjëse dhe kanë ndikuar në caktimin e lartësisë së gjobës së shqiptuar, në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 274/2014 më datën 11.06.2014.



**Këshillë Juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*